



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr 5886 Prot

Gjirokastër më 31/05/2022

Lënda : Dërgohet dokumenti i parë PBA 2023-2025 në Bashkinë Gjirokastër”.


**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
TIRANË**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. Datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendor”, Udhëzimit nr 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, si dhe në mbështetje të shkresës nr 6160 prot, datë 05.04.2022 nga MFE, ju vendosim në dispozicion dokumentin e fazës së parë PBA 2023-2025 në Bashkinë Gjirokastër.

Faleminderit për bashkëpunimin.

KRYETAR

Flamur Golemi







BASHKIA GJIROKASTËR

**PROJEKT DOKUMENTI
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2023 - 2025**

MAJ 2022



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË GJIROKASTËR	10
3. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GJIROKASTËR 2023-2025	12
3.1 TË ARDHURAT E BASHKISË GJIROKASTËR NË VITET 2023-2025	12
3.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjirokastrë.	14
3.1.2 Burimet e të ardhurave dhe metodologjia e parashikimit afatgjatë të tyre	15
3.1.3 Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	27
3.1.4 Kapacitetet fiskale të taksapaguesve	31
3.1.5 Transferrat nga pushteti qendror	36
3.2 ANALIZA E RISQVE DHE MASAT PARANDALUESE	37
3.2.1 Kuptimi i riskut dhe menaxhimi i tij	37
3.2.2 Vlerësimi i riskut	38
3.2.3 Reagimi ndaj riskut	38
3.2.4 Aktivitetet e kontrollit	38
3.2.5 Monitorimi dhe raportimi	38
3.2.6 Rregjistrimi i menaxhimit të riskut për të ardhurat vendore	39
3.3 PLANI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR PERIUDHËN 2023-2025	40
2.4 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	45
4. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	51
PROGRAMI 01110	52
PROGRAMI 03140	61
PROGRAMI 04130	77
PROGRAMI 06260	92
PROGRAMI 08130	110
PROGRAMI 09120	127
PROGRAMI 10430	145

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Gjirokastrë	11
Tabela 2. Taksa e tabelës	22
Tabela 3. Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesisë.	23
Tabela 4. Taksa e fjetjes ne hotel.	24
Tabela 5. Taksa ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja dhe sherbime te tjera	24
Tabela 6. Tarifat e enteve publike	29
Tabela 7. Taksa dhe tarifa per abonentet familjar	29
Tabela 8. Ngarkesa fiskale sipas Nj. Administrative sipas zërave kryesore	30
Tabela 9. Ngarkesa fiskale sipas tatimpaguesve.	31
Tabela 10. Kapaciteti I Biznesit Te Vogel Sipas Natyres Se Tyre	32
Tabela 11. Nr.i familjeve me lehtësi fiskale	34
Tabela 12. Familje me lehtësi fiskale/Efekti (mijë lekë)	35

Tabela 13. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.	40
Tabela 14. Shpenzimet sipas Programeve 2019-2025	41
Tabela 15. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas Funksionit	43
Tabela 01110-1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	52
Tabela 01110-2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	53
Tabela 01110-3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	54
Tabela 01110-4. Projektet e Investimeve të Programit	60
Tabela 01110-5. Të Dhëna mbi Programin	60
Tabela 03140-1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	61
Tabela 03140-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	62
Tabela 03140-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	66
Tabela 03140-4. Projektet e investimeve	76
Tabela 03140-5. Të Dhëna mbi Programin	76
Tabela 04130-1. Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike	77
Tabela 04130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	78
Tabela 04130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	82
Tabela 04130-4. Projektet e Investimeve të Programit	91
Tabela 04130-5. Të dhëna Bazë të Programit	91
Tabela 06260-1. Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike	92
Tabela 06260-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	94
Tabela 06260-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	98
Tabela 06260-4. Projektet e Investimeve të Programit	109
Tabela 06260-5. Të Dhëna Bazë të Programit	109
Tabela 08130-1. Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike	110
Tabela 08130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	111
Tabela 08130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	114
Tabela 08130-4. Projektet e Investimeve të Programit	125
Tabela 08130-5. Të dhëna Bazë të Programit	125
Tabela 09120-1. Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike	127
Tabela 09130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	128
Tabela 09130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	132
Tabela 09120-4. Projektet e Investimeve të Programit	144
Tabela 09120-5. Të Dhëna Bazë të Programit	144
Tabela 10430-1. Shpenzimet e programit sipas kategorive ekonomike	145
Tabela 09130-2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	146
Tabela 09130-3. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	147
Tabela 10430-5. Të Dhëna Bazë të Programit	149

Lista e Grafikëve

Grafiku 1. Të Ardhurat e Bashkisë Gjirokastrë sipas Burimit (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit)	14
Grafiku 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme në tre vite 2020-2021-2022.	19
Grafiku 3. Të ardhurat për vitin 2020-2021 (plan-fakt).	20
Grafiku 4. Peshë specifike në numër që zë çdo grupim i taksapaguesve	31
Grafiku 5. Peshë specifike që zënë bizneset	32
Grafiku 6. Shpenzimet e Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike	41
Grafiku 7. Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Funksioneve Bashkiake	44

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVQV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto



1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të

njesisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësitë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjat' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"

- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2023-2025 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të

PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.



2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË GJIROKASTËR

Bashkia Gjirokastrë administron një sipërfaqe prej 478 km² dhe ka një popullsi prej 52.000 banorësh sipas gjendjes civile. Në zbatim të ligjit 115 "Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrises vendore në Republikën e Shqipërisë" Bashkia Gjirokastrë përbëhet nga Njësia Administrative qytet dhe gjashtë njësi të tjera të cilat janë: Njësia Administrative Picar, Njësia Administrative Cepo, Njësia Administrative Lunxhëri, Njësia Administrative Lazarat dhe Njësia Administrative Odrie me 31 fshatra. Në zbatim të ligjit 115 "Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrises vendore në Republikën e Shqipërisë" Bashkia Gjirokastrë është rritur si në sipërfaqe ashtu edhe në funksione. Për përmbushjen e objektivave të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj komunitetit Bashkia Gjirokastrë funksionon në zbatim të ligjeve prej të cilëve janë hartuar metodologji dhe udhëzime të brendshme të cilat garantojnë konsolidim të vlerësimit të të ardhurave dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve në komunitet.



Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Gjirokastrë

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë						
	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i Njësive Administrative	7.0					
Numri i Fshatrave	31.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km ²)	478km ²					
Qyteti	4,093.0					
Njësiti Administrativ	39,963.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km ²)	-					
Zonë Urbane	4,093.0					
Tokë Bujqësore	6,793.0					
Kullota	12,452.0					
Pyje	10,170.8					
Popullsia e Bashkisë		52,030	52,029	51,875	51,573	50,541
Qyteti		33,713	33,710	33,652	33,473	32,803
Njësiti Administrativ		18,317	18,319	18,223	18,100	17,738
Moshë Mesatare e Popullsisë		-	-	-	-	-
Numri i Lindjeve		247	321	322	124	96
Numri i Vdekjeve		253	264	333	158	91
Numri i Bizneseve Aktive		1,082	1,078	1,105	1,250	1,304
Numri i Familjeve		16,520	16,864	17,058	17,137	9,304
Qyteti		11,293	11,539	11,671	11,751	6,311
Njësiti Administrativ		5,227	5,325	5,387	5,386	2,993
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		625	632	610	617	617
Administrata e Bashkisë		122	-	-	-	-
Njësiti Shpenzuese		503	-	-	-	-
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		39	39	47	47	55
Administrata e Bashkisë		-	-	-	-	-
Njësiti Shpenzuese		-	-	-	-	-
Numri i Programeve Buxhetore		12	12	12	13	13


3. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GJIROKASTËR 2023-2025

3.1 Të Ardhurat e Bashkisë Gjirokastrë në vitet 2023-2025

Kjo nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

BURIMET BUDGETORE		2020	2021	2022	2023	2024	2025
		Reali	Plani	Bush. Filleshtar	Prishimi	Plani	Plani
9	TE ARDHURA nga Burimet e Njës	173,041	189,722	210,210	-	212,222	216,102
A.1	Te Ardhura nga Takset Lokale	40,274	43,969	30,745	-	31,237	31,477
A.1.1	Takset vendore mbi henes dhe vogeli	3,843	-	-	-	-	-
A.1.2	Taksa mbi prurjet e pastajshme	24,483	25,082	44,972	-	43,012	43,874
A.1.2.1	Taksa mbi ndertimin	25,035	25,082	27,297	-	27,670	28,047
A.1.2.2	Taksa mbi lirin e pajtojshme	5,989	4,035	6,423	-	6,429	6,234
A.1.2.3	Taksa mbi lirin e pajtojshme	461	725	137	-	125	131
A.1.2.4	Taksa mbi lirin e pajtojshme pas urdhe	620	2,932	724	-	751	739
A.1.3	Takset vendore mbi shpallimin dhe lirin	372	954	1,173	-	1,159	1,222
A.1.4	Takset ndalimit ne infestimin dhe ne ndalimin e reze	2,963	6,623	2,000	-	3,100	32,02
A.1.5	Takset taksat	-	1	-	-	-	-
A.1.6	Takset vendore mbi shpallimin dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Takset e pajtojshme	404	287	-	-	-	-
A.1.8	Takset e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.1.9	Takset e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	23,060	23,633	27,240	-	27,663	28,052
A.2.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.2.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	12,394	23,431	21,240	-	21,663	22,340
A.2.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.2.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	6,466	5,251	6,000	-	6,000	6,000
A.2.5	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	625	-	-	-	-
A.3	Te Ardhura nga Takset e Njës	23,060	23,633	27,240	-	27,663	28,052
A.3.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	23,222	23,147	42,662	-	42,232	44,005
A.3.1.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	17,321	17,148	16,170	-	16,233	16,361
A.3.1.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	720	1,000	1,062	-	1,062	1,144
A.3.1.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	10,851	1,389	22,429	-	22,143	22,693
A.3.1.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	22,732	23,605	27,392	-	27,708	27,827
A.3.2.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	16,026	14,932	22,444	-	22,298	24,011
A.3.2.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	360	720	3,662	-	3,675	3,695
A.3.2.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	3,246	7,237	10,223	-	10,437	10,221
A.3.2.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	6,044	6,006	2,047	-	2,044	2,021
A.3.2.5	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	6,044	6,006	2,792	-	2,792	2,792
A.3.2.6	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	1,20	-	1,21	1,24
A.3.2.7	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	5,04	-	3,820	3,821
A.3.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	19,374	23,908	15,308	-	15,322	16,058
A.3.3.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	774	-	622	-	629	708
A.3.3.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	29	222	1,107	-	1,112	1,129
A.3.3.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	4,227	-	1,20	-	662	670
A.3.3.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	127	226	3,30	-	3,30	3,31
A.3.3.5	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.3.6	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	2,006	1,222	1,117	-	1,112	1,129
A.3.3.7	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	5,000	-	-	-	-
A.3.3.8	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	3,646	3,605	5,222	-	5,222	5,240
A.3.3.9	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	427	222	400	-	405	424
A.3.3.10	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	3,140	3,112	3,073	-	3,117	3,125
A.3.3.11	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.3.12	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.3.13	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	261	466	300	-	300	300
A.3.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	2,077	7,227	9,213	-	10,072	10,228
A.3.4.1	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.4.2	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	1,116	1,270	3,067	-	3,230	3,472
A.3.4.3	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.4.4	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.4.5	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.4.6	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.4.7	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	227	-	-	-	-	-
A.3.4.8	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	2,208	6,437	6,725	-	6,262	7,000
A.3.4.9	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	231	-	-	-	-	-
A.3.5	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.6	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	131	123	-	-	-	-
A.3.7	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Taksa mbi lirin e shpallimit dhe lirin e pajtojshme	3,236	2,430	3,720	-	3,236	3,011
A.4	Te Ardhura nga Takset e Njës	23,060	23,633	27,240	-	27,663	28,052
A.4.1	Te Ardhura nga Takset e Njës	23,060	23,633	27,240	-	27,663	28,052
A.4.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Te Ardhura nga Takset e Njës	431	292	300	-	300	300
A.4.8	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	16	-	-	-	-
A.4.9	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.12	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Te Ardhura nga Takset e Njës	13,394	14,236	14,824	-	15,073	15,223
B	Te Ardhura nga Takset e Njës	39,423	26,233	28,937	-	420,045	442,135
B.1	Te Ardhura nga Takset e Njës	210,644	218,304	218,323	-	224,617	226,123
B.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	14,294	17,029	17,466	-	6,762	6,762
B.2.1	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	6,762	6,762
B.2.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	14,294	17,029	17,466	-	-	-
B.3	Te Ardhura nga Takset e Njës	174,477	123,063	123,306	-	123,306	123,306
C	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
C.1	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
C.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	-	-	-	-	-	-
D	Te Ardhura nga Takset e Njës	69,072	107,476	123,128	-	90,000	90,000
D.1	Te Ardhura nga Takset e Njës	45,103	73,082	88,200	-	70,000	70,000
D.2	Te Ardhura nga Takset e Njës	23,970	34,394	34,928	-	20,000	20,000
D.3	Te Ardhura nga Takset e Njës	64,140	24,394	34,928	-	722,622	769,061

Grafiku 1. Të Ardhurat e Bashkisë Gjirokastrë sipas Burimit (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit)



3.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjirokastrë.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave të cilat krijohen dhe administrohen nën autonominë e Bashkisë Gjirokastrë sipas legjislacionit në fuqi. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit të mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu për afruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Numri total i familjeve që parashikohet të përfshihet në skemën e detyrimeve fiskale është 8.587 familje. Për 1.026 familje janë parashikuar lehtësi fiskale për shkak të problemeve sociale. Bazuar në regjistrin aktual, në total numri i bizneseve që parashikohen të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale është 1.323.

Biznesi i vogël zë 81% të numrit total, gjithashtu në detyrimet fiskale përfshihen edhe 39 institucione buxhetore.

Një faktor i rëndësishëm është planifikimi i mbështetur në shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas vendodhjes gjeografike, duke lehtësuar subjektin tatimpagues sipas taksimit të diferencuar. Ndërgjegjësimi bizneseve dhe qytetareve ndaj detyrimeve fiskale është një tjetër faktor i rëndësishëm. Të ardhurat për frymë janë llogaritur mbi numrin e përgjithshëm të banoreve të Bashkisë Gjirokastrë dhe Njësive Administrative të marë nga Zyra e Gjendjes Civile, i cili është 52.000 banorë.

Rritja, rimëkëmbja ekonomike dhe pavarësia e njësisë së qeverisjes vendore është sfida kryesore e Bashkisë Gjirokastrë. Me politikat fiskale ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike më afatgjata. Eksperienca, përballja me sfidat dhe problematikat, konsultimet me ekspertë dhe grupe interesi, por edhe vizioni i qartë i institucionit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar, vijnë të konkretizuara në metodologjinë e vlerësimit të të ardhurave në periudhë afatgjatë.

Agroturizmi dhe prodhimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i ekonomisë në Gjirokastrë. Zonat e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në Gjirokastrë, edhe pas disa investimeve të kryera në Njësitë Administrative, përballen me nevojën e madhe për mirëmbajtje dhe investime të tjera në kullim, vaditje, përmirësimin dhe krijimin e lrave të reja, mbjelljen e druve pyjore, përmirësimin e fondit pyjor, hartimin e planeve të menaxhimit të fondit kullosor dhe pyjor. Zbatimii Reformës Administrativo-Territoriale kanë treguar se ndryshimet e ndjeshme në sipërfaqe, numër popullsie, por edhe shërbime, kërkojnë angazhim më të mirë në përdorimin e fondeve.

Këto ndryshime po pasohen edhe me rikonceptime e ndryshime ligjore e nënligjore, si për organizimin e qeverisjes, buxhetimit, sistemit fiskal e për të gjitha fushat të cilat i kanë kaluar në funksion të këtyre njësive. Të gjitha këto ndryshime që janë bërë në vazhdimësi do të shërbejnë si instrument për rritjen e efikasitetit administrativ, profesional dhe teknik të qeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Nivelet e taksave vendore, janë kryesisht të miratuara me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, por për nevojat e qeverisjes vendore dhe në konsultim me komunitetin, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë edhe taksa të përkohshme, që i shërbejnë një objekti të caktuar për përmirësimin e situatave në infrastrukturë e territorin brenda juridiksionit të bashkisë.

3.1.2 Burimet e të ardhurave dhe metodologjia e parashikimit afatgjatë të tyre

Burimet e financimit të Bashkisë Gjirokastrë përbëhen prej të ardhurave nga taksat e tarifat vendore të njësisë administrative Gjirokastrë dhe gjashtë njësive administrative të tjera, duke përfshirë dhe donacionet e ndryshme si dhe të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo e kushtëzuar nga pushteti qëndror.

3.1.2.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohet çdo person fizik, juridik, vendas ose i huaj që zotëron një pasuri të paluajtshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga niveli i përdorimit. Në këtë taksë përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Taksa mbi ndërtesën

Baza e taksës mbi ndërtesën është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror për çdo kat mbi dhe nën nivelin e tokës. Dokumenti bazë për përcaktimin e sipërfaqes së ndërtesës është certifikata e pronësisë ose cdo document tjetër brenda ekstremiteteve administrative që vërteton pronësinë ose përdorimin e pasurisë. Në rastet kur nuk disponohet asnjë prej dokumentave të lartë përmendura atëherë bëhet vetëdeklarimi pranë Bashkisë. Taksës së ndërtesës i nënshtrohen:

- Personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- Zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijon:

- a) 100 (një qind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, date 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

Niveli i taksës për subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Bashkinë Gjirokastrë do të jetë 185 lekë/m², ku të gjitha përllogaritjet do të bëhen në bazë të metodologjisë së kadastrës fiskale.

Niveli i taksës mbi ndërtesat për Nj.Administrative do të ulet në masën 35% mbi çmimin e referencës dhe 30 % ulje mbi shkallën e taksimit.

Detyrimi për taksën e ndërtesës është vjetor. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Metodologjia e përdorur nga Bashkia Gjirokastrë për vjeljen e kasaj takse do t'i sigurojë buxhetit në periudhë afatgjatë një rritje me 5% të ardhurash.Me qëllim përcaktimin e saktë të sipërfaqes së pronës që do t'i nënshtrohet taksimit Bashkia Gjirokastrë nëpërmjetë inspektorve tatimor ka bërë verifikimin në vend të sipërfaqessë pronës. Dhe si rezultat i kësaj Bashkia Gjirokastrë ka rregjistruar në sitemin e saj tatimor sipërfaqen e ndërtesës në 5 Njësitë Administrative.

"Agjent tatimor për vjeljen e taksës për ndërtesat të cilat përdoren per qëllime banimi, është Ujësjiellës-Kanalizime Sh.a, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera strukturë e ngarkuar është Drejtoria e të Ardhurave".

Taksa mbi ndertesat	Shkalla e takses	Niveli i takses
a-Ndertesa banimi (70 m) pa vertetim hipotekor para vitit 1993	0.05 %	24 lekë/m ²
b. Ndertesa banimi (100 m) pa vertetim hipotekor pas vitit 1993		
a/1 Ndertesa banimi para 1993 (ne baze te vertetimit hipotekor te paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 lekë/m ²
b/1 Ndertesa banimi pas 1993 (ne baze te vertetimit hipotekor te paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 lekë/m ²
d-Siperfaqe per tregeti e sherbime, ndertim, siperfaqe prodhimi, Zona muzeale.	0.2%	185 lekë/m ²
c-Siperfaqe per veprimtari bujqesore dhe blegtorale	0.2%	37 lekë/m ²

Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi apo në përdorim të tatimpaguesit. Dokumenti bazë për përcaktimin e sipërfaqes sëtokës është çertifikata e pronësisë ose çdo dokument tjetër që vërteton përdorimin e saj. Në rastet kur nuk disponohet asnjë prej dokumentave të lartë përmendura atëherë bëhet vetëdeklarimi pranë Bashkisë. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	2.800
II	2.100
III	1.400
IV	1.350
V	1.250
VI	1.200
VII-X	1.100

Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.


“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të ardhurave, pronave publike, lejeve dhe lishencave pranë Bashkisë Gjirokastrë”.

Taksa mbi truallin


Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja në metër katror e tokës (jo bujqësore) brenda vijës kufizuese të ndërtesës e vërtetuar me dokumenta ligjor. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qellime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qellime biznesi
Bashkia Gjirokastrë	0,28 lekë/m ²	15 lekë/m ²

Grafiku 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme në tre vite 2020-2021-2022.



Grafiku 3. Të ardhurat për vitin 2020-2021 (plan-fakt).



Krahasimi i parashikimit të të ardhurave përgjatë 2 viteve të fundit tregojnë rritje progresive faktinë trendin e të ardhurave. Përsa i përket vitit 2020 kemi një realizim të të ardhurave në masën 85 %, për vitin 2021 kemi një realizim në masën 99 %.

Referuar vitit 2020 duhet të merret në konsiderat situata e vështirë me të cilën u përball gjithë republika dhe jo vetëm por gjithë bota.

Sipas të dhënave të ilustruara në grafik duket qartë tendenca e rritjes së mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, e cila vjen për shkak të ristrukturimit të Drejtoriasë së të ardhurave, pronave publike, lejeve dhe lishencave duke bashkëpunuar me Drejtoritë e tjera. Kjo tendencë parashikohet të mbahet edhe për vitin 2022 duke u bazuar edhe te ndryshimet e propozuara në paketën fiskale.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës të pakushtëzuar nga pushteti qendror. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e

taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

3.1.2.2 Taksa e tabelës

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin tabela të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregëtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Tabelat kategorizohen në:

- i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit më shumëse një tabelë identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
- ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formëndhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejtvendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
- iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregëtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
- iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejës së dhënë nga njësia evetëqeverisjes vendore.

Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo Grafiku, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose

ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj.

Në rastin kur tabela përbëhet vetem nga gërma të veçuara, simbole, logo apo Grafiku të vendosura, të gdhëndura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, Grafikut, logo dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe gërma, simbole dhe Grafiku për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që fumizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele.

Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelë identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet me pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij.

Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele. Kjo takse aplikohet për të gjitha subjektet fizik, juridike, private e shtetërore, vendas apo te huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Gjirokastrë.

Tabela 2. Taksa e tabelës

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matese	Niveli i takses
1	Takse tabele per qellime identifikimi te trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve (ku shenohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri ne 2 m ²	Lekë/m ²	0
b	Mbi 2m² deri 10 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	10.000
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	15.000
	-elektronike	Lekë/m ²	20.000
c	Mbi 10m² deri 20 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	8.500
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	12.750
	-elektronike	Lekë/m ²	17.000
d	Mbi 20m² deri 40 m²		
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	5.500
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	8.250
	-elektronike	Lekë/m ²	11.000
e	Mbi 40 m²		

	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	4.000
	e thjeshte (pa ndriçim)	Lekë/m ²	6.000
	-elektronike	Lekë/m ²	8.000
2	Tabele për qëllime reklamimi e levizshme e palevizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	- E thjeshte (me/pa ndriçimi)	Lekë/m ² /vit	22.500
	- Elektronike	Lekë/m ² /vit	45.000
3	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	- Te të gjitha llojeve dhe permasave	Lekë/m ² /dite	1.000

Detyrimi dhe kështet e pagesës:

- Detyrimi i taksës së tabelës për qëllime reklamimi për subjektet që aktiviteti kryesor i tyre është reklamimi do të ndahet në katër kështe 3-mujore sipas akt-marrëveshjeve të lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave.
- Për subjektet e reja të hapura gjatë vitit, taksa e tabelës do të llogaritet proporcionalisht me ditët e ushtrimit të aktivitetit, pra që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3.1.2.3 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, parakryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre, dhe niveli tregues i taksës është 2 % per qind.

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive Të Paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit të taksave, përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhen për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë Gjirokastrë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela 3. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë.

Nr	Kategoria	Njesia matjes	Niveli i takses
1	Ndertesa banimi	Lekë/m ²	300
2	Ndertesa për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	700
3	Ndertesa të tjera	Lekë/m ²	500

3.1.2.4 Taksa vendore në shërbimin hotelier

Baza e kësaj takes është çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës në bazë të numrit të netëve të qëndruara. Kjo taksë llogaritet mbi bazën e taksës së vendosur nga bashkia, të cilën e paguan klienti dhe mbledhet nga ofruesi i shërbimit për llogari të bashkisë. Parashikimi i taksës për periudhën afatgjatë është bërë në bazë të kapaciteteve dhe numrit të njësive duke përfutur rritje në të ardhurën.

“Hotel” kupton çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emertimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpipritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

- Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- Niveli tregues i taksës është sipas tabelës bashkëlidhur.
- Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia përnatë qëndrimi me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hotelipër llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohetçmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tabela 4. Taksa e fjetjes ne hotel.

Nr	Taksa e fjetjes ne hotel	Njesia	Niveli i takses
1	Hotel me 4-5 yje	lekë/nate qendrimi/per person	175
2	Bujtine, fjetine, motel dhe çdo njesi tjeter akomoduese, sipas percaktimeve te ligjit per turizmin	lekë/nate qendrimi/per person	70

3.1.2.5 Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Tabela e mëposhtme na njeh me bazen e takses së ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja, të percaktuara në ligjin 95/2018 datë 13.12.2018, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, si dhe disa shërbime të tjera të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Inspektoriatit të Mbrotjes së Territorit Vendor.

Tabela 5. Taksa ndikimit ne infrastrukturë nga ndertimet e reja dhe shërbime të tjera

Nr	Taksa e ndikimit ne infrastrukturë	Niveli i takses	Baza e takses/tarifes
	- Ndertime për qëllime banimi, tregëti, shërbimi (deri në 250 m ²)	Cmimin e shitjes për m ²	4%
	- Ndertime për qëllime banimi, tregëti, shërbimi (mbi 250 m ²)	Cmimin e shitjes për m ²	8 % (jo më pak se 30.000 lekë)

- Ndertime per qellime turizmi, industri, bujqesi, ndertues individual per banim	Mbi vleften e investimit	3 %
-Ndertime per qellime publike per projekte ne infrastrukture per te gjitha llojet	Mbi vleften e investimit	0.1 %
-Objekt i pare legalizim	Mbi vleften e investimit	0.5 %
-Objekte te dyta e me radhe per legalizim	Mbi vleften e investimit	8 %
-Ndertime ne Qendren Historike per banim	Mbi vleften e investimit	2 %
- Ndertime ne Qendren Historike per hoteleri etj	Mbi vleften e investimit	3 %
-Objekte banimi ne zona malore	Mbi vleften e investimit	1 %
-Hotele/Resort me 5 yje status special (brand name)	Mbi vleften e investimit	0 %
-Objekte certifikuar agroturizem sipas ligjit per turizmin	Mbi vleften e investimit	0 %
-Ndertimet e reja per shoqerite me kapital te zoteruar nga Bashkia Gjirokaster ne masen 100 % dhe ndermarrjet e B. Gjirokaster per te gjitha ndertimet e reja apo nderhyrjet rehabilituese ne infrastrukturen ku investitor apo perfitues i nje projekti te financuar nepermjet marreveshjeve, granteve apo huave	Mbi vleften e investimit	0 %
Tarife sherbimi per dhenie leje zhvillimi		
1- Kur zhvilluesi eshte individ		
a-Per ndertesa 1-3 kate mbi toke	Lekë	10.000
b-Per ndertesa mbi 3 kate mbi toke	Lekë	10.000
c-Per infrastrukture	Lekë	10.000
2- Kur zhvilluesi eshte subjekt		
a-Per ndertesa 1-3 kate mbi toke	Lekë	10.000
b-Per ndertesa mbi 3 kate mbi toke	Lekë	30.000
c-Per infrastrukture	Lekë	20.000
Tarife aplikimi per sherbimet e meposhtme te ofruara nepermjet sistemit elektronik te lejeve		
1- Kur zhvilluesi eshte individ		
a-Deklarate paraprake per kryerje punimesh	Lekë	5.000
b-Leje zhvillimi	Lekë	10'000
c-Leje per ndryshimin e funksionit	Lekë	5.000
ç-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe deri ne 250 m ²	Lekë	5.000
d-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe deri ne 250 m ²	Lekë	5.000
dh-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe me te madhe se 250 m ²	Lekë	5.000
e-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe me te madhe se 250 m ²	Lekë	5.000
f-Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndertimit	Lekë	5.000
g-Çertifikate perdorimi	Lekë	5.000
gj-Leje ndertimi per prishje ndertimi ekzistues	Lekë	5.000

h-Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Lekë	5.000
i-Leje ndertimi per rikonstrukcion me ndryshim funksioni	Lekë	5.000
j-Leje infrastrukture	Lekë	5.000
i-Leje per ndryshimin e subjektit zhvillues	Lekë	5.000
k-Leje per ndryshimin e projektit gjate ndertimit	Lekë	5.000
l-Njoftim per fillimin e punimeve	Lekë	1.000
ll-Njoftim per ndryshimin e subjektit zbatues	Lekë	1.000
m-Njoftim per raportin e mbikqyrjes	Lekë	1.000
n-Njoftim per raportin e kolaudimit	Lekë	1.000
2- Kur zhvilluesi eshte subjekt		
a-Deklarate paraprake per kryerje punimesh	Lekë	10.000
b-Leje zhvillimi	Lekë	10.000
c-Leje per ndryshimin e funksionit	Lekë	10.000
ç-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe deri ne 250 m ²	Lekë	10.000
d-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe deri ne 250 m ²	Lekë	10.000
dh-Leje ndertimi per ndertim te ri, me siperfaqe me te madhe se 250 m ²	Lekë	10.000
e-Leje ndertimi per shtese ne ndertim ekzistues, me siperfaqe me te madhe se 250 m ²	Lekë	10.000
f-Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndertimit	Lekë	10.000
g-Çertifikate perdorimi	Lekë	10.000
gj-Leje ndertimi per prishje ndertimi ekzistues	Lekë	10.000
h-Leje ndertimi per rikonstrukcion pa ndryshim funksioni	Lekë	10.000
i-Leje ndertimi per rikonstrukcion me ndryshim funksioni	Lekë	10.000
j-Leje infrastrukture	Lekë	10.000
k-Leje per ndryshimin e subjektit zhvillues	Lekë	10.000
l-Leje per ndryshimin e projektit gjate ndertimit	Lekë	10.000
ll-Njoftim per fillimin e punimeve	Lekë	1.000
m-Njoftim per ndryshimin e subjektit zbatues	Lekë	1.000
n-Njoftim per raportin e mbikqyrjes	Lekë	1.000
o-Njoftim per raportin e kolaudimit	Lekë	1.000
Tarife sherbimi per :		
a-Kryerje punimesh per te cilat nuk eshte e nevojshme pajisja me leje ndertimi apo deklarate paraprake per kryerje punimesh	Lekë	2.000
Tarifa per dhenie fotokopje te njesuar		
a.Tarife per dhenie dokumenta nga arkiva	Lekë	300
b.Fotokopje e njesuar 1:500 v.1938-1988, format A4.	Lekë	200
c.Fotokopje te studimeve urbanistike ne fuqi, ne format A3	Lekë	300
d.Fotokopje te studimeve urbanistike ne fuqi, ne format A4	Lekë	200
e.Fotokopje e çdo dokumenti te njesuar, format A4	Lekë	200

f. Fotokopje e çdo dokumenti të njesuar, format A3	Lekë	300
-Vendim për leje ndërtimi të çdo lloji	Cdo sherbim	10.000
-Certifikate përdorimi	Cdo sherbim	10.000
-Vendim për ndryshim projekti	Cdo sherbim	10.000
-Konfirmim kufijsh për banesa dhe toka bujqësore	Cdo sherbim	500
-Proces-verbal dorezimi pasurie të paluajtshme	Cdo sherbim	15.000
-Vendim VKM nr. 608	Cdo sherbim	10.000
-Vendim VKM nr. 329	Cdo sherbim	10.000
-Konfirmim të objekteve në proces legalizimi	Cdo sherbim	500

3.1.3 Të Ardhurat nga Taksat e Ndara

Sipas përcaktimit të ligjit për procedurat tatimore dhe ligjeve të vecanta Bashkitë përfitojnë prej taksave të cilat ndahen nga pushteti qëndror me atë vendor dhe konkretisht :

- ✓ 97% të të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individët, personat fizik dhe juridikë.
 - ✓ 25% e të ardhurave nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve të përdorura
 - ✓ 5% e të ardhurave nga renta minerare.
 - ✓ 2% e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
- **taksa për dhënie autorizimi për pikat e tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit.**

Bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 970 datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie të licencave për tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të saj", Bashkia Gjirokastrë jep autorizime për personat juridik dhe fizik, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e lëndëve djegëse për automjete (pikat e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë së saj. Licencat jepen nga Bashkia Gjirokastrë **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë:

- Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet dhe vajra lubrifikantë të jetë **1 000 000** lekë.
- Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë të jetë **100 000** lekë.

3.1.3.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", dhe ligjeve të tjera të vecanta pushteti vendor ka autonomi të plotë të vendosi tarifa për një shërbim apo një të drejtë që u jepet komunitetit. Niveli i

tarifës orientohet që të mbulojë shërbimin e ofruar por që kjo gjë nuk arrihet si rezultat i shumë faktorve. Shërbimet publike duhen të jenë të matshme nëpërmjet instrumentave specifik të cilët sigurojnë transparencën, aksesueshmërinë, cilësinë, sasinën dhe koston.

- Tarifa për menaxhimin e mbetjeve
- Tarifa për ndricimin rrugor
- Tarifa për gjelbërimin
- Tarifat për shërbimet administrative
 - a) Tarifa për dhënie lishencash
 - b) Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit
 - c) Tarifa për vulosje veterinarë të bagëtive të therura
 - d) Tarifat e parkimit për automjetet e lishencuara dhe vend parkimet publike
 - e) Tarifat për pyjet dhe kullotat
 - f) Tarifat për shërbimet shtesë nga zjarrfiksjat
 - g) Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave
 - h) Tarifat nga dokumentat për tender, ankand etj
 - i) Tarifa të institucioneve të arsimit, kuturës, sportit etj
 - j) Tarifa për furnizim me ujë dhe kanalizime
 - k) Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kanalizimeve
 - l) Tarifa të tjera

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Gjirokastrë dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Në klasifikimin biznes i vogël përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor të barabartë ose më pak se 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat juridik që trajtohen me tatim të thjeshtuar të fitimit mbi biznesin e vogël)

Në klasifikimin biznes i madh përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat fizik dhe juridik që trajtohen me tatim fitimi).

Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor. Për subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Tarifës së ndricimit i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Gjirokastrë dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së ndricimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Në klasifikimin biznes i vogël përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor të barabartëose më pak se 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat juridik që trajtohen me tatim të thjeshtuar të fitimit mbi biznesin e vogël)

Në klasifikimin biznes i madh përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat fizik dhe juridik që trajtohen me tatim fitimi).

Tarifave të përkohshme i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Gjirokastrë dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së ndriçimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Në klasifikimin biznes i vogël përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor të barabartëose më pak se 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat juridik që trajtohen me tatim të thjeshtuar të fitimit mbi biznesin e vogël)

Në klasifikimin biznes i madh përfshihen të gjitha bizneset person fizik apo juridik të cilat kryejnë një qarkullim vjetor mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë. (në këtë kategori përfshihen personat fizik dhe juridik që trajtohen me tatim fitimi).

Tarifave të ndriçimit dhe pastrimit i nënshtrohen të gjithë entet publike, që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda territorit të Bashkisë Gjirokastrë dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së ndriçimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabela 6. Tarifat e enteve publike

Nr	Kategoria e tarifës	Niveli i tarifës	Baza e tarifës
1	Tarife e pastrimit	Lekë/vit	60.000
2	Tarife e ndriçimit	Lekë/vit	30.000

Tabela 7. Taksa dhe tarifa per abonentet familjar

Nr	Kategoria e tarifës	Niveli i takses/tarifës	Baza e takses/tarifës
1	Taksa e ndertesës	Lekë/vit	2.400
1	Tarife e pastrimit	Lekë/vit	2.400
2	Tarife e ndriçimit	Lekë/vit	1.800
3	Tarife e gjelberimit	Lekë/vit	400

4	Tarife infrastrukture për arsim, sport, kulturë	Lekë/vit	1.200
---	---	----------	-------

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

- Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës është si me poshtë: 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- ✓ Për individët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është kryer verifikimi në terren për ndërtesat e banimit para vitit 1993, do të aplikohet për efekt të përlogaritjes së detyrimit një sipërfaqe fikse 70 m². (Qytet)
- ✓ Për individët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është kryer verifikimi në terren për ndërtesat e banimit pas vitit 1993, do të aplikohet për efekt të përlogaritjes së detyrimit një sipërfaqe fikse 100 m². (Qytet)
- ✓ Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë paguhet çdo muaj. Agjent tatimor për vjeljen e taksës për ndërtesat të cilat përdoren për qëllime banimi dhe tarifën e tjeraeshte Ujësjetllës-Kanalizime Sh.a

Përfjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- ✓ ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- ✓ ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

Përfjashtohen nga taksa mbi ndërtesat dhe tarifën e tjera familjare:

Për personat me aftësi të kufizuara, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbit kur njëri nga kryefamiljarët (bashkëshorti/bashkëshortja) dhe nuk kanë persona të tjerë madhore në familje me përfjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes.

Të ardhurat vendore për vitin 2022 llogariten në 210.370 mijë lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifën dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga tarifën në masën 52%.

Zërat e tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave për vitin 2022 janë kryesisht: Tarifa për menaxhimin e mbetjeve në masën 21%, Tarifa për ndricim publik në masën 13%, Tarifa e shërbimeve administrative të bashkisë në masën 7%, tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës dhe sportit në masën 9%, tarifa të tjera në masën 2%. Këto 5 zëra kryesorë mbulojnë rreth 52 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Gjirokastrë.

Tabela e mëposhtme pasqyron në mënyrë analitike ngarkesën fiskale sipas Njësive Administrative:

Tabela 8. Ngarkesa fiskale sipas Nj. Administrative sipas zërave kryesore

	Nj.A Pëcar	Nj.A Odrë	Nj.A Cepo	Nj.A Lunxheri	Nj.A Lazarat	Nj.A Antigon e
T.mbi token bujqes.	1013	498	1940	2082	706	743
Kullote	1623	479	778	900	350	520



T.Ndertese	500	366	1213	888	1999	530
Trf.pastrimi	313	185	453	420	801	265
Trf.ndricimi	241	153	300	369	487	231
Trf.infrast.per arsim	197	145	290	381	446	210
Varreza	102	113	183	190	252	150
Automjete	623	276	1067	867	2137	487
Te tjera	424	126	444	832	407	199
TOTALI	5,036	2,341	6,668	6,929	7,585	3,335

Tabela 9. Ngarkesa fiskale sipas tatimpaguesve.

Nr	Bashkia Gjirokastr	Familjet		Biznesi I Vogel	Biznesi I Madh	Institucion e
		Reziden t	JoReziden t			
I	Nj.A Gjirokastr	6,177	2,410	926	171	39
II	Nj.A te tjera	2,421	2,141	145	42	
1	Nj.A Cepo	492	549	24	8	
2	Nj.A Lazarat	737	91	47	23	
3	Nj.A Lunxheri	550	648	27	1	
4	Nj.A Odrie	125	213	5	2	
5	Nj.A Picar	255	418	26	6	
6	Nj.A Antigone	262	222	16	2	
	TOTALI	8,598	4,551	1,071	213	39

3.1.4 Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet në të gjitha Njësitë Administrative.

3.1.4.1 Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktualë, në total numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Gjirokastr është 1,323. Biznesi i vogël zë 82 % të numrit total të bizneseve. Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 39.

Grafiku 4. Pësia specifike në numër që zë çdo grupim i taksapaguesve




Tabela 10. Kapaciteti i Biznesit Te Vogel Sipas Natyres Se Tyre


Nr.	Bashkia Gjirokastra	Biznes i Vogel	Njesi	Njesi	Profesione
			Tregetare/ Sherbimi	prodhim i	te lira
I	Nj.A Gjirokastra	926	852	28	46
II	Nj.A te tjera	145	124	19	2
	Picar	26	17	9	
	Cepo	24	22	2	
	Odrie	5	4	1	
	Lunxheri	27	23	4	
	Antigone	16	14	2	
	Lazarat	47	44	1	2
	TOTALI	1,071	976	47	48

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Gjirokastra është 8,587 familje.

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëttimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për invalidët, të verbër, paaftësi, paraplegjikë etj, të cilët përbëjnë rreth 1,406 familje.


Grafiku 5. Peshat specifike që zënë bizneset



Në bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 92 % ndaj totalit të bizneseve të vegjël.



Në tabelën e mësipërme, për bizneset e mëdhenj vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 61 % ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj



Për subjektet tregëtare që ushtrojnë aktivitet në zonën historike të përfshira nga investimi TID Gjirokastra, do të ketë një ndryshim.

Tarifa për pastrimin

Në zonën historike do të kategorizohet në:

- a) Njësi tregtare ishte 3.000 lekë/vit – do të bëhet 9.000 lekë/vit
- b) Bar-Restorant ishte 5.000 lekë/vit – do të bëhet 13.000 lekë/vit
- c) Hotele (1-6 dhoma) ishte 3.000 lekë/vit – do të bëhet 9.000 lekë/vit
- d) Hotele (7-16 dhoma) ishte 6.000 lekë/vit – do të bëhet 15.000 lekë/vit
- e) Hotele (mbi 16 dhoma) ishte 50.000 lekë/vit – do të bëhet 75.000 lekë/vit

Tarifa për ndriçimin rrugor.

- a) Njësi tregtare ishte 3.000 lekë/vit – do të bëhet 8.000 lekë/vit
- b) Bar-Restorant ishte 5.000 lekë/vit – do të bëhet 8.000 lekë/vit
- c) Hotele (1-6 dhoma) ishte 3.000 lekë/vit – do të bëhet 8.000 lekë/vit
- d) Hotele (7-16 dhoma) ishte 6.000 lekë/vit – do të bëhet 8.000 lekë/vit
- e) Hotele (mbi 16 dhoma) ishte 20.000 lekë/vit – do të ngelet njësoj

➤ **Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit**

Tarifa për vjeljen dhe grumbullimin e bimëve medicinale etero-vajore si më poshtë:

- ✓ Herba të ndryshme - 70 lekë/kv
- ✓ Leje transporti sipas urdhërit nr. 143 të Ministrisë së Mjedisit – 100 lekë / cope

➤ **Taksat dhe tarifat për familjet me lehtësi fiskale**

Bashkia Gjirokastër në kuadrin e mbledhjes së të ardhurave dhe shpërndarjen e tyre është treguar e kujdesshme jo vetëm në shërbime dhe investime, por dhe në trajtimin e familjeve me lehtësi fiskale:

- ✓ për personat të cilët gjatë vitit kalendarik klasifikohen në listën e personave me të ardhura nën nivelin minimal jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivelin kombëtar.
- ✓ Për personat me aftësi të kufizuara, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbrit kur njëri nga kryefamiljarët (bashkëshorti/bashkëshortja) dhe nuk kanë persona të tjerë madhorë në familje me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes.

Taksat dhe tarifat për këtë kategori shoqërore do të **zerohen**.

Më konkretisht:

- 1) **Tarifa e pastrimit** - nga 150 lekë/muaj do të shkojë në 0 lekë/muaj.
- 2) **Tarifa e ndriçimit** - nga 150 lekë/muaj do të shkojë në 0 lekë/muaj.
- 3) **Tarifa e gjelbërimit** – për individët invalidë do të shkojë në vlerën 0 lekë/muaj.
- 4) **Tarifa e infrastrukturës për arsim, sport, kulturë** – do të shkojë në vlerën 0 lekë/muaj
- 5) Gjithashtu këto familje nuk do të paguajnë tarifat për shërbimet që ofron Bashkia si psh:
 - Deklaratë e paraqitjes mujore të familjes – do të bëhet 0 lekë
 - Deklaratë e gjëndjes ekonomike dhe sociale të familjes – do të bëhet 0 lekë
 - Librezë ndihmë ekonomike – do të bëhet 0 lekë
 - Të dhëna të tjera sociale të familjes – do të bëhet 0 lekë

- Vërtetimet për shërbime të ndryshme

Tabela 11. Nr.i familjeve me lehtësi fiskale

	Nr.Total	INVALID	Pens.te	VERBER	PAAFTESI	PARAPLEGJ.	TOTALI
		Invalid Gr.II+IV	plote				
Nj.A Gjirokaster	548	299	249	85	263	24	920
Totali Nj.A	259	165	94	45	169	13	486
Nj.A Cepo	59	36	23	9	44	2	114
Nj.A Lunxheri	105	70	35	16	54	3	178
Nj.A Lazarat	38	25	13	4	29	1	72
Nj.A Picar	24	16	8	7	21	7	59
Nj.A Odrie	10	4	6	6	9	0	25
Nj.A Antigone	23	14	9	3	12	0	38
TOTALI	807	464	343	130	432	37	1406

Tabela e mëposhtme tregon **efektin negativ** që sjell në çdo zë të të ardhurave, si pasojë e uljes së taksave dhe tarifave për invalidët, të verbër, të paaftë dhe paraplegjikë. Ulja 100 % sipas kategorisë në planin e të ardhurave është 6,749 mijë lekë. (e paraqitur në tabelën e mëposhtme)

Tabela 12. Familje me lehtësi fiskale/Efekti (mijë lekë)

LLOJI I TE ARDHURES	Nj.Adm Gjirokaster	Nj.Adm te tjera	SHUMA
A.TE ARDHURA JOTATIMORE	5,630	1,119	6,749
2.Tarifa e pastrimit	1,656	292	1,948
3.Tarifa e ndricimit	1,656	292	1,948
4.Tarifa e infrast.per arsim	1,656	292	1,948
5.Varrezat		243	243
6.T.gjelberimi	662		662
TOTALI	5,630	1,119	6,749

- ✓ Tarifa për pasuritë shtetërore që jepen me qera për truall (V.K.M nr. 54, dt. 05.02.2014) do të jetë 100 lekë/m²/vit. (Struktura përgjegjëse -Drejtoria e të Ardhurave, Zyra e Pronave)
- ✓ Licencë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt rrethqytetëse – 40.000 lekë për një afat 10 vjeçar. (Struktura përgjegjëse- Zyra e Shërbimeve)
- ✓ Tarifë shërbimi për asgjësimin e produkteve dhe mallrave ushqimore etj. të skaduara – 0.2 % mbi vlerën e mallrave që do të asgjësohet (Struktura përgjegjëse- Zyra e Shërbimeve)
- ✓ Tarifë parkimi 1-vjeçare për taksitë dhe linjat e shërbimit urban dhe rrethqytetës – ishte 3.000 lekë do të bëhet 4.000 lekë/vit për çdo mjet.
- ✓ Certifikatë dublikatë – ishte 500 lëke bëhet 1.000 lekë/shërbim
- ✓ Lëshim vërtetimi për efekt tenderi

- B.Vogël ishte 500 lekë bëhet 1.000 lekë
- B.Madh (në bazë të formularit të vlerësimit) ishte 1.000 lekë bëhet 4.000 lekë
- ✓ Lëshim dokumentacioni nga arkivi – ishte 200 lekë bëhet 100 lekë/faqe
- ✓ Lëshime dokumentacioni nga arkivi në mënyrë elektronike –ishte 100 lekë bëhet 50 lekë/faqe

- Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit
Tarifat për kullotat do të ndryshojnë si më poshtë:

	Ishte	Bëhet
- Kullotë dimërore për dhen	150 lekë/krerë	100 lekë/krerë
- Kullotë dimërore për dhi	150 lekë/krerë	100 lekë/krerë
- Kullotë verore për dhen	150 lekë/krerë	100 lekë/krerë
- Kullotë verore për dhi	150 lekë/krerë	80 lekë/krerë
- Pyje kullosore për dhen	100 lekë/krerë	50 lekë/krerë
- Pyje kullosore për dhi	150 lekë/krerë	100 lekë/krerë
- Prerje gjethe	40 lekë/vandak	10 lekë/kv

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e kullotave është Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Gjirokastër”.

Vlerësimi i të ardhurave për periudhën afatmesme 2023-2025 paraqitet me një rritje mesatare 1 %. Vlerësimi afatmesëm është bazuar mbi faktorë si :

- a) Vlerësimi i impaktit të faktorëve të rinj.
- b) Përmirësim i përdorimit të potencialit tatimor
- c) Përmirësimi i përdorimit të potencialit tarifor
- d) Rritja e pritshme e vëllimit të aktivitetit

3.1.5 Transferrat nga pushteti qendror

3.1.5.1 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara të cilat përdoren në autonomi të plotë dhe transferta të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën. Ligji i ri nr 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” përcakton qartë rregullat, politikat, instrumentat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e shtetit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” transferta e pakushtëzuar në një vit buxhetor është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto. Granti i pakushtëzuar nuk mund të jetë më vogël se shuma e grantit të shpërndarë në një vit më parë. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndahet midis bashkive sipas formulës e cila konsiston por nuk kushtëzohet në a) popullsinë rezidente, b) dendësinë e popullsisë, c) numrin e nxënësve në arsimin parauniversitar. Në bazë të procedurës të përcaktuar në ligj për vitin 2022 Bashkia Gjirokastër ka përfituar grant të pakushtëzuar në shumën 219 985

mijë lekë. Në mbështetje të udhëzimit nr 8, datë 28.02.2022, planifikimi në mijëra lekë i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2023 paraqitet në shumën 234 967 lekë, për vitin 2024 në shumën 250 480 lekë, për vitin 2025 në shumën 267 185 lekë.

3.1.5.2 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Në zbatim të legjislacionit në fuqi bashkitë përfitojnë transfertë të kushtëzuar për mbulimin e kostos së funksioneve të deleguar dhe për projekte të vecanta të konsideruara në interes vendor ku dhe kërkohet bashkëpunimi me pushtetin vendor. Transferta specifike financojnë funksione të reja të transferuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme të qëndrueshme financimi gjithashtu financojnë shërbime në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme ku dhe kërkohet bashkëpunimi i qeverisjes vendore. Transferta specifike është shpërndarë si më poshtë:

1. Konviktet e arsimit parauniversitar, të cilat megjithëse kanë qënë pjesë e Bashkisë prej vitesh, vetëm në transfertën specifike të vitit 2021 janë akorduar fonde, në një vlerë prej 18.070 mijë lekë. Për vitin 2022 janë akorduar 18.262 mijë lekë, ku përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

2. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH). Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin me një vlerë totale 30 619 mijë lekë, ndërkohë për vitin 2021 transferta e pakushtëzuar sektoriale ishte në vlerën 29 441 mijë lekë. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

3. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor. Gjatë vitit 2021 funksioni i deleguar i arsimit parashkollorë përfitoi grant në vlerën 99 612 mijë lekë. Për vitin 2022 parashikohet fond për personelin mësimor në shumën 82 347 mijë lekë dhe për stafin mbështetës në vlerën 25 210 mijë lekë, në total 107 557 mijë lekë.

4. Personeli jomësimor në arsimin parauniversitar. Gjatë vitit 2021 funksioni i deleguar i arsimit parauniversitar përfitoi grant në vlerën 6 045 mijë lekë dhe për vitin 2022 parashikohet grant specifik në shumën 6 287 mijë lekë.

5. Rrugët rurale. Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për rrugët rurale të transferuara, në një vlerë totale 8 278 mijë lekë. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

6. Administrimi i pyjeve. Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për Shërbimin Pyjor me një vlerë totale 7 335 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

6. Ujitja dhe Kullimi. Në transfertën specifike të vitit 2022, janë fondet për ujitjen dhe kullimin me një vlerë totale prej 10 168 mijë lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Në mbështetje të udhëzimit nr 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025", pika 20, ku specifikohet se ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale do të jentë në të njëjtat nivele sipas transfertës së miratuar për buxhetin e vitit 2022.

3.2 Analiza e risqeve dhe masat parandaluese

3.2.1 Kuptimi i riskut dhe menaxhimi i tij

Në kuptim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar "Risk" është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë.

Menaxhimi i riskut përfshijë identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Risku mund të ketë ndikim afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Këto riqe janë të lidhura përkatësisht me objektivat operacione afatshkurtra, afatmesme dhe strategjike. Objektivat operacional janë objektivat afatshkurtra të përcaktuara në planifikimin buxhetor, llogaritja, analiza financiare e të ardhurave të veta, ndjekja e politikave zhvilluese dhe sensibilizuese të krijimit të të ardhurave si dhe konsolidimi i mardhënive me tatimpaguesin. Menaxhimi i riskut nuk është i njëtrajtshëm por është ndërthurja e disa komponentve kompleks.

3.2.2 Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut është gjykimi që mbështetet në ekspertizën dhe përvojën e vlerësuesit të riskut dhe nivelin e informacionit që disponohet në momentin e vlerësimit. Ka tri parime të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut:

- Sigurimi i një procesi të strukturuar qartë të cilin si mundësia e ndodhjes dhe ndikimianë konsideruar për çdorisk;
- Vlerësimi i riskut nënjë mënyrë të tillë qëlehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioriteteve të riskut;
- Evidentimi i qartë i dallimit midis, riskut të natyrshëm dhe riskut të mbetur.

Vlerësimiduhet të paraqitet sa më shumë të jetë e mundur në një evidencë të paanshmetë pavarur, duke marrë në konsideratë aktoret që të preken ngarisku, dhe të shmangurvlerësiminkonfuz objektiv të riskutme gjykiminnë lidhje mepranueshmërinë e riskut.

Ky vlerësim duhet të bëhet duke vlerësuar si mundësinë e ndodhjes së riskut dhe ndikimitnë qoftë se risku ështërealizuar. Risqet e identifikuar mund të zvogëlohen ose kufizohen nëpërmjet futjes së aktiviteteve të duhura të kontrollit.

3.2.3 Reagimi ndaj riskut

Gjatë hartimit të regjistrit të riskut duhen përshkruar si masat e marra ashtu edhe ato të planifikuara, me karakter riparues, duke u mbështetur në dokumentet dhe në rregulloren e brendshme të Bashkisë, të tilla si urdhra, shkresa, procedura të detajuara të miratuara të cilat ngarkojnë me përgjegjësi stafin.

Nëse nga analizat e kryera rezulton se masat e marra deri më tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedura dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët probabiliteti

3.2.4 Aktivitet e kontrollit

Aktivitet e kontrollit janë rregulla, procedura dhe veprime që synojnë uljen e risqeve në mënyrë që të arrihen objektivat. Gjatë zbatimit të aktiviteteve, titullari duhet të marri parasysh përfitimet e pritshme si dhe koston e zbatimit të tyre. Aplikimi me vones i aktiviteteve është më i kushtueshëm dhe më pak efikas.

3.2.5 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi është ndoshta faza më e rëndësishme e procesit të menaxhimit të riskut. Ekspozimi ndaj riskut ndryshon me kalimin e kohës dhe për këtë arsye duhet të bëhet përditësimi i regjistrit të riskut.

